



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – DSHMS

Plani Komunal për Zhvillimin Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor (PKZHIKPSH) Drenas 2020-2024

KONCEPTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Çka është koncepti i Mjekësisë Familjare?

Mjekësia familjare i përkushtohet më shumë personit dhe familjes sesa një grupi të sëmundjeve apo teknikave special,

Nuk ka kufizime në grup moshë apo gjini të pacientëve,

Ofron kujdes të arritshëm (afërsi gjeografike, kulturë, gjuhë)

Kuptimi i sëmundjes në kontekst të historisë personale, familjare dhe sociale të pacientit

KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR

Çka është Kujdesi Parësor Shëndetësor – Shërbimet?

Parandalimi i sëmundjeve

Trajtimi i sëmundjeve akute dhe kronike

Rehabilitimi

Ndihma shtëpiake për të paaftë ose të dobët fizikisht

Menaxhimi i sëmundjeve që zgjasin shumë

Menaxhimi i kujdesit Palitativ


ORGANIZIMI I KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR

Si organizohet Kujdesi Parësor Shëndetësor – Drenas?

1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF,
(Drenas)

5 Qendra të Mjekësisë Familjare – QMF
(Komoran, Gllanasellë, Arllat, Tërstenik dhe Baicë)


7 Ambulanca të Mjekësisë Familjare – AMF
(Nekoc, Sankoc, Gradicë, Dobrashec, Abri, Poklek, Terdec)



Shërbimet e institucioneve të KPSH-së?


1. Shërbimet e promovimit shëndetësor, përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin
2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese
3. Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike
4. Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent
5. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike
6. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjtë
7. Shërbimet e planifikimit familjar
8. Shërbimet e kujdesit ante/peri dhe post natal
9. Shërbimet e shëndetit oral parandalues
10. Shërbimet e shëndetit mendor
11. Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshire shërbimet e kujdesit neonatal dhe atij terminal palitativ
12. Shpërndarja e barërave nga lista esenciale

NUMRI I VIZITAVE NËPËR QENDRAT E MJEKËSISË FAMILJARE - DRENAS



DIAGNOZAT MË TË SHPESHA TË PARAQITURA NË KOMUNËN E DRENASIT

Cilat janë diagnozat më të shpesha – Drenas?



PLANI KOMUNAL I ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL TË KPSH-së

Cila është rëndësia e Planit të Zhvillimit Institucional të KPSH-së?

Ky Plan është i rëndësishëm për sistemin shëndetësor të Komunës së Drenasit, dhe koordinon përpjekjet tona për përmirësimin e shëndetit, ofrimin e shërbimeve cilësore dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët.

Duke u bazuar në parimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor, ky plan përcakton orientimin e Komunës së Drenasit, respektivisht, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për të ofruar shërbime efikase shëndetësore, të integruara dhe të qasshme për të gjithë komunitetin e Drenasit, duke siguruar kështu një progres të qëndrueshëm në shëndetin publik

PLANI KOMUNAL I ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL TË KPSH-së

VIZIONI

Shëndet më i mirë për të gjithë, më shumë vite jetë, nëpërmjet shërbimeve shëndetësore cilësore të qëndrueshme dhe të përballeshme për të gjithë banorët e komunës së Drenasit.

MISIONI

Misioni i sistemit shëndetësor është mbrojtja, përmirësimi dhe promovimi i shëndetit dhe mirëqenies për të gjithë banorët e komunës tonë, duke ofruar shërbime efikase shëndetësore e mjekësore dhe duke siguruar një progres të qëndrueshëm në shëndetin publik.

PLANI KOMUNAL I ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL TË KPSH-së

PARIMET

Plani Komunal për Zhvillimin Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor është i bazuar në vlerësimin e shëndetit si një e drejtë e njeriut, e cila garantohet përmes kujdesit shëndetësor efektiv dhe efikas, në parimet e barazisë, solidaritetit, integritetit, bashkëpërgjegjësisë, jo diskriminimit, transparencës dhe llogaridhënies.

1. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të Mjekësisë Familjare,
2. Organizimit më të mirë të burimeve njerëzore,
3. Përmirësimi i sistemit të informimit shëndetësorë,
4. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore me teknologji esenciale dhe bashkëkohore për pacientët,
5. Qëndrueshmëri më të mirë financiare shëndetësore dhe
6. Qeverisje dhe përgjegjësi menaxheriale zingjirore të sistemit shëndetësorë.

PLANI KOMUNAL I ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL TË KPSH-së

OBJEKTIVAT

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, sigurisë së shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme dhe lehtësisht të qasshme për të gjithë banorët e Komunës së Drenasit.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

- OS.1.** Shërbime cilësore dhe të qasshme të cilat iu përgjigjen standardeve shëndetësore për nevojat e komunitetit,
- OS.2.** Promovimi dhe edukimi shëndetësor,
- OS.3.** Riorganizimi në KPSH.

PLANI KOMUNAL I ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL TË KPSH-së

Ri-sistemimi i stafit në Mjekësinë Familjare?

PLANIFIKIMI I SISTEMIMIT NË MJEKËSINË FAMILJARE					
#	Institucioni	Banorë	<i>Gjendja aktuale</i>	Doktor	Infermierë
1	QMF Drenas	17497	15	9	18
2	QMF Komoran	17100	6	8	16
3	QMF Terstenik	7101	1	3	6
4	QMF Gllanaselle	5509	2	3	6
5	QMF Arllat	5990	1	3	6
6	QMF Baice	5204	2	3	6
			27	29	58

PLANI KOMUNAL I ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL TË KPSH-së

Statistika të Planit?

43

PROBLEME TË IDENTIFIKUARA

1

OBJEKTIVË E PËRGJITHSHME

3

OBJEKTIVA SPECIFIKE

15

REZULTATE

101

AKTIVITETE PËR ARRITJEN E REZULTATEVE

Plani 2 vjeçar i veprimit me kosto prej 4,035,492.00 euro për realizimin e këtij Planit.

Ju faleminderit për vëmendjen!